



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 14755 Prot.

Lezhë, më 19/ 08/ 2020

Lënda: **Kërkesë për pajisje me Akt Përputhshmërie në kuadër të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë.**

AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Rr: "Muhamet Gjollështa", Nr.57, Tiranë

Të nderuar,

Bashkia Lezhë ka të miratuar dhe në fuqi aktualisht Planin e Përgjithshëm Vendor me vendimin Nr. 194 datë 25.09.2017 të Këshillit Bashkiak Lezhë dhe Vendimin Nr. 6 datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Pas miratimit të këtij Plani Bashkia Lezhë ka monitoruar zbatimin e tij në vazhdimësi dhe ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij për disa arsye të cilat janë trajtuar në dokumentin e nismës së rishikimit të PPV-së.

Në zbatim të nenit 23, pika 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 13, pika 1, shkronja "b", neneve 23, 24, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, neneve 10, 11 dhe 12 VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", e ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 1 datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "*Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar*", Bashkia Lezhë ka kryer procesin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e saj administrativ.

Në vijim, bazuar në nenin 9, pika 2 nenit 13, pika 1, shkronja "d", nenit 23, nenit 25 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Nenit 2, pika 2, neneve 5, 6 dhe 8, nenit 60, pika 3, shkronja "a", nenit 62, pika 2, shkronjat "a", "b" dhe "c" të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", e ndryshuar, kërkojmë nga AKPT lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë.

KRYETARI

PJERIN NDREU

Drejtoria: D.P.T.ZH.U

Miratoi: Nik Leka

Konc: A. Laçi